

Ligji Nr. 04/L-198
PËR TREGTINË E MALLRAVE STRATEGJIKE

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR TREGTINË E MALLRAVE STRATEGJIKE

Neni 1

Qëllimi

1. Ky ligj rregullon eksportin, importin, transitin, trans-ngarkimin, ri-eksportin dhe ri-transferimin e mallrave strategjike, ofrimin e shërbimeve të ndërlidhura, si dhe kontrollin, mbikëqyrjen, të drejtat dhe detyrimet e palëve që marrin pjesë në aktivitetet e biznesit nga kjo fushë.
2. Qëllimi i këtij ligji është ta avancojë sigurinë shtetërore dhe interesat e politikës së jashtme të Republikës së Kosovës, drejt përmbushjes së detyrimeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare në lidhje me mospërhapjen e armëve të shkatërrimit në masë dhe mallrave tjera strategjike të shfrytëzuara për qëllime ushtarake dhe t'i kontribuojë përpjekjeve ndërkombëtare dhe rajonale për rregullimin e tregtisë me mallrat strategjike.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Ky ligj rregullon kufizimin ose ndalimin e eksportit, importit, transimit, trans-ngarkimit dhe ri-eksportit të mallrave strategjike që hyjnë, dalin ose që kalojnë nëpër territorin e Republikës së Kosovës, përfshirë ri-eksportin jashtë territorial, ri-transferimin dhe ofrimin e shërbimeve të ndërlidhura dhe që kanë të bëjnë me ndonjë nga mallrat që i nënshtrohen këtij ligji.

2. Ky ligj zbatohet ndaj:

- 2.1. secilit person fizik ose juridik në territorin e Republikës së Kosovës, duke përfshirë të gjitha zonat e lira tregtare, zonat e lira doganore, dhe hapësirën ajrore;
- 2.2. secilit shtetas të Republikës së Kosovës, brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës;
- 2.3. secilit person juridik i cili në Republikën e Kosovës e ka të regjistruar zyrën, selinë ose veprimtarinë e përhershme të biznesit, si dhe zyrat përfaqësuese ose subsidiare të personit në vendin e huaj;
- 2.4. secilit person të huaj, i cili gjendet jashtë territorit të Republikës Kosovës dhe që operon në emër ose nën kontrollin e personit nga Republika e Kosovës.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

- 1.1. **Qeveria** – Qeveria e Republikës së Kosovës.
- 1.2. **Ministria** – Ministria përkatëse për Tregti dhe Industri.

1.3. **Ministri** – Ministri përkatëse për Tregti dhe Industri.

1.4. **Departament** - Departamenti specifik për mallra strategjike brenda Ministrisë përkatëse për Tregti dhe Industri.

1.5. **Komision** – Komisioni për tregtinë me mallra strategjike.

1.6. **Mallrat strategjike** – çdo mall për përdorim ushtarak dhe të dyfishtë, duke përfshirë mallrat nga Lista Shtetërore e Mallrave të Kontrolluara Strategjike; mallrat të cilat tërësisht apo pjesërisht mund të përdoren për zhvillimin, prodhimin, përdorimin, mirëmbajtjen, magazinimin, detektimin, identifikimin ose përhapjen e armëve kimike, biologjike apo bërthamore ose pajisjeve tjera, ose për zhvillimin, mirëmbajtjen, apo magazinimin e mjeteve për dërgimin e tyre; ose mallrave tjerë sipas përdorimit të fundit apo përdoruesit të fundit.

1.7. **Mallrat ushtarake** – mallrat të cilat kryesisht, por jo ekskluzivisht, janë të dizajnuara, zhvilluar, konfiguruar, adaptuara, montuara, prodhuara ose modifikuara për përdorim ushtarak ku hyjnë edhe teknologjitë dhe softuerët e mallrave përkatëse.

1.8. **Përdorim përfundimtar ushtarak** – nënkupton:

1.8.1. përfshirjen në “mallrat ushtarake” në Lista Shtetërore e Mallrave të Kontrolluara Strategjike;

1.8.2. përdorimi i pajisjeve prodhuese, testuese apo analitike si dhe të komponentëve të tyre, për zhvillimin, prodhimin ose mirëmbajtjen e “mallrave ushtarake” nga Lista Shtetërore e Mallrave të Kontrolluara Strategjike;

1.8.3. përdorimi i çdo produkti të papërfunduar në fabrikë, për prodhimin e “mallrave ushtarake” nga Lista Shtetërore e Mallrave të Kontrolluara Strategjike.

1.9. **Mallrat për përdorim të dyfishtë** – mallrat, përfshirë softuerët dhe teknologjinë e cila mund të përdoret si për qëllime civile, ashtu edhe për qëllime ushtarake, ky hyjnë të gjitha mallrat të cilat mund të përdoren për qëllime jo eksplozive (jo shpërthyes) ose të cilat në çfarëdo mënyrë mund të ndihmojnë në tërësi ose pjesërisht në zhvillimin, prodhimin, përdorimin, mirëmbajtjen, magazinimin, detektimin, identifikimin apo përhapjen e armëve kimike, biologjike ose bërthamore ose pajisjeve tjera, ose për zhvillimin, mirëmbajtjen apo magazinimin e mjeteve për dërgimin e tyre.

1.10. **Teknologjia** – informacioni specifik i nevojshëm për zhvillimin, prodhimin ose përdorimin e mallrave strategjike. Ky informacion ka formën “të dhënat teknike” ose “asistencë teknike”.

1.11. **Të dhënat teknike** – skicat, planet, diagramet, modelet, formulat, projektet dhe specifikat inxhinierie, doracakët dhe udhëzuesit (e shkruar ose të regjistruar – përfshirë softuerët), si dhe çdo media tjetër apo pajisje të tilla sikur, disqet, shiritat dhe memoriet vetëm të lexueshme.

1.12. **Shërbimet e ndërlidhura** – Ndërmjetësimi, transportimi, shërbimet financiare dhe ofrimi i asistencës teknike.

1.13. **Ndërmjetësim** – nënkupton:

1.13.1. negociatat apo marrëveshjet e transaksioneve (kontraktuale) për blerje, shitje ose furnizim me mallra strategjike nga Republika e Kosovës në shtetin e huaj ose nga një shtet i huaj në shtetin tjetër;

1.13.2. shitja ose blerja e mallrave strategjike në shtetin e huaj me qëllim të transferimit të tyre në shtetin tjetër të huaj.

1.13.3. për qëllimet e këtij ligji, “ndërmjetësimi (brokering)” konsiderohet si “shërbim i ndërlidhur.”

1.14. **Ndërmjetësuesi (Broker)** – personi i cili i nënshtrohet këtij ligji dhe që ofron shërbime të ndërmjetësit.

1.15. **Transport** – akti i bartjes së mallrave strategjike, marrëveshja për bartjen e tyre, organizimi ose lehtësimi i bartjes së tyre, ofrimi i shërbimeve mbështetëse transportuesit dhe çdo akt tjetër me të cilin llogaritet se e ndihmon furnizimin me këto mallra ose dorëzimin e tyre, atëherë kur kjo i kontribuon armëve kimike, biologjike ose bërthamore ose pajisjeve tjera bërthamore apo mjeteve për dërgimin e tyre, ose të mallrave ushtarake kur ato i destinohen vendit ndaj të cilit është vënë embargo ose janë vënë sanksionet ose palës së ndaluar. Për qëllimet e këtij ligji, “transport” konsiderohet “shërbim i ndërlidhur.”

1.16. **Shërbime financiare** – vënia në dispozicion ose ofrimi i fondeve për të lehtësuar bartjen e mallrave strategjike dhe/ose shërbimeve të ndërlidhura, atëherë kur kjo i kontribuon armëve kimike, biologjike ose bërthamore ose pajisjeve tjera bërthamore apo mjeteve për dërgimin e tyre, ose të mallrave ushtarake kur ato i destinohen vendit ndaj të cilit është vënë embargo ose janë vënë sanksionet ose palës së ndaluar. Për qëllimet e këtij ligji, “shërbimet financiare” konsiderohen si “shërbime të ndërlidhura.”

1.17. **Asistenca teknike** – çdo mbështetje teknike që ka të bëjë me riparimin, zhvillimin, prodhimin, montimin, testimin ose mirëmbajtjen e mallrave strategjike si dhe çdo shërbim tjetër teknik në formë të udhëzuesit të shkruar apo gojor, trajnim dhe bartje e njohurive ose shkathtësive të punës ose shërbime tjera konsultative, duke përfshirë transferimin e të dhënave teknike. Për qëllimet e këtij ligji, asistenca teknike konsiderohet si “shërbim i ndërlidhur”. Kontrolli i asistencës teknike nuk zbatohet ndaj informatave publike, ndaj kërkimeve shkencore bazike ose ndaj informacioneve minimale të nevojshme në aplikacionet për patentim.

1.18. **Eksport** – dorëzimi ose dërgimi jashtë territorit të Republikës së Kosovës, përfshirë këtu edhe ri-eksportimin e mallrave strategjike, dhe transmissi i softuerëve ose teknologjisë personalisht ose përmes mediave elektronike, përfshirë këtu telefaksin, telefonin, postën elektronike ose çfarëdo pajisje tjetër elektronike, dhe që destinohen jashtë Republikës së Kosovës. Për qëllimet e këtij ligji, shpalsja ose transferimi i të dhënave teknike, çoftë personalisht apo përmes telefaksit, telefonit, postës elektronike apo çfarëdo pajisjeje tjetër elektronike, personit të huaj brenda territorit të Republikës së Kosovës apo jashtë saj, konsiderohet si “eksport.”

1.19. **Eksportues** – personi fizik apo juridik në emër të të cilit bëhet deklarata e eksportit dhe i cili e mban kontratën me pranuesin e dërgesës në shtetin e huaj dhe është i autorizuar të dërgojë mallra jashtë territorit të Republikës së Kosovës, të transmetojë ose të vë në dispozicion softuerin apo teknologjinë personalisht apo përmes telefaksit, telefonit, postës elektronike ose çfarëdo mjeti tjetër elektronik personit të huaj në territorin e Republikës së Kosovës ose jashtë, konsiderohet se është “eksportues”.

1.20. **Ri-eksportim** – eksportimi i mallrave strategjike nga Republika e Kosovës që paraprakisht janë importuar në Republikën e Kosovës.

1.21. **Import** – hyrja e mallrave strategjike ose transferimi i përkohshëm apo i përhershëm i teknologjisë në territorin e Republikën e Kosovës, përfshirë edhe ri-importin.

1.22. **Importues** – personi fizik ose juridik që merret me importimin e mallrave strategjike në Republikën e Kosovës.

1.23. **Transit** – hyrja brenda e pastaj dalja e dërgesave të mallrave strategjike nga territori i Republikës së Kosovës të cilat janë të destinuara jashtë territorit të saj dhe në atë mënyrë që malli strategjik gjatë tërë kohës qëndron në të njëjtin mjet transportues.

1.24. **Personi që kryen transitin (transitori)** – personi fizik ose juridik i cili është i autorizuar ose përgjegjës për transitin e mallrave strategjike përmes Republikës së Kosovës.

1.25. **Trans-ngarkim** – mënyrë e transportimit të mallrave strategjike me mjetin transportues i cili hyn në territorin e Republikës së Kosovës, ku malli strategjik shkarkohet nga ai mjet transportues dhe ngarkohet në mjetin tjetër transportues me destinacion përfundimtar jashtë Republikës së Kosovës.

1.26. **Personi që kryen trans-ngarkimin** – personi fizik ose juridik i cili është i autorizuar ose përgjegjës për trans-ngarkimin e mallrave strategjike në Republikën e Kosovës.

1.27. **Ri-eksportim jashtë territorial** – transportimi ose transmissiion prej një shteti të huaj në tjetrin të mallrave të licencuara strategjike paraprakisht të importuara nga Republika e Kosovës.

1.28. **Ri-transferim jashtë territorial** – transportimi ose transmissiion prej një personi fizik ose juridik në personin tjetër fizik ose juridik të mallrave të licencuara strategjike paraprakisht të importuara nga Republika e Kosovës.

1.29. **Licencë individuale** – autorizimi i një eksportuesi të caktuar, importuesi, ri-eksportuesi, ri-transferuesi, personi që kryen transitin, trans-ngarkimin ose shërbime të ndërlidhura, që të kryej aktivitetet e përmendura me këtë ligj, përkitazi me një përdorues të fundit, një pranues të dërgesës ose një shitës në shtetin e huaj dhe për një ose më shumë mallra strategjike.

1.30. **Licencë globale** – autorizimi i dhënë eksportuesit të caktuar për një lloj ose kategori të mallrave strategjike, i cili mund të vlejë për eksportim të një ose më shumë përdorues të fundit të përcaktuar dhe/ose të një ose më shumë shtete të huaja.

1.31. **Licencë e përgjithshme** – autorizimi për importim, eksportim, transit ose trans-ngarkim të mallrave strategjike të përcaktuara ose të shërbimeve të ndërlidhura e të përcaktuara nën kushtet dhe në shtetet e destinacionit të specifikuar në licencën e përgjithshme.

1.32. **Certifikata ndërkombëtare e importit** – dokumenti që përmban konfirmimin nga Komisioni se importuesi i mallrave ka marrë përsipër të importoj në Republikën e Kosovës mallrat në vlerën dhe sasinë e specifikuar dhe se nuk do të ri-eksportoj ose ri-transferoj mallrat pa licencë përkatëse.

1.33. **Certifikata e përdorimit të fundit** – dokumenti që përmban konfirmimin nga Komisioni se përdoruesi i fundit ka marrë përsipër të importojë mallra strategjike në vlerën dhe sasinë e specifikuar dhe për qëllimet e specifikuar në certifikatë dhe se nuk do të ri-eksportoj ose ri-transferoj mallrat pa licencë përkatëse.

1.34. **Certifikata për verifikimin e dërgesës** – nënkupton:

1.34.1. dokumentin që përmban konfirmimin nga Komisioni se pranuesi i mallrave në Republikën e Kosovës, i ka pranuar mallrat në vlerën dhe sasinë e specifikuar;

1.34.2. dokumentin që përmban konfirmimin nga autoritetet kompetente të qeverive të huaja se pranuesi i mallrave strategjike të Republikën e Kosovës i ka pranuar mallrat në vlerën dhe sasinë e specifikuar në shtetin e destinacionit.

1.35. **Palë e refuzuar** – person fizik ose juridik në shtetin e huaj, të cilit personi nga Republika e Kosovës nuk mund t'i shesë ose eksportojë, t'i ofrojë shërbime të ndërlidhura ose me të cilin nuk mund të zhvillojë biznes me mallra strategjike.

1.36. **Institucionet e autorizuar shtetërore të sigurisë** – institucionet shtetërore të cilat sipas ligjeve relevante janë të lejuara të posedojnë dhe bartin armë.

1.37. **PBP** - Programi i brendshëm i pajtueshmërisë për transportues - sigurimi pajtueshmërinë me të gjitha rregulloret dhe standardet e komunitetit të kontrollit të eksportit global nga ana e tregtarëve të mallrave strategjike.

Neni 4

Komisioni për kontrollin e tregtisë me mallra strategjike

1. Komisioni për kontrollin e tregtisë me mallra strategjike formohet me vendim të Qeverisë së Republikës e Kosovës.
2. Komisioni përbëhet nga pesë (5) anëtarë dhe zëvendës anëtarë, përfaqësues të:
 - 2.1. Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë;
 - 2.2. Ministrisë së Punëve të Jashtme;
 - 2.3. Ministrinë për Forcën e Sigurisë;
 - 2.4. Ministrisë së Punëve të Brendshme
 - 2.5. Doganës së Kosovës;
3. Secili anëtar ose zëvendës anëtar i Komisionit është përgjegjës për çështjet brenda kompetencave të ministrisë të cilën ai apo ajo e përfaqëson.
4. Komisioni aprovon, anulon, ndryshon dhe revokon licencat për eksport, import, transit, trans-ngarkim, ri-eksportim jashtë territorial, ri-transferim dhe për ofrimin e shërbimeve të ndërlidhura dhe detyra tjera siç parashihet në këtë ligj dhe akte nënligjore.
5. Komisioni përcakton Listen Shtetërore të Mallrave të Kontrolluara Strategjike.
6. Anëtarët dhe zëvendësit e Komisionit emërohen dhe shkarkohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës bazuar në propozimet e ministrive përkatëse.
7. Komisioni kryesohet nga përfaqësuesi i Ministrisë përkatëse për Tregti dhe Industri.
8. Aprovimi për eksport, import, transit, trans-ngarkim, ri-eksportim jashtë territorial, ri-transferim dhe ofrim të shërbimeve të ndërlidhura jepet nga Komisioni me konsensusin e arritur nga të gjithë anëtarët e Komisionit. Në rast të mungesës së një (1) prej anëtarëve të Komisionit, e drejta për të votuar i bartet zëvendësit të tij. Nëse anëtarët e Komisionit nuk arrijnë konsensus atëherë Komisioni vendosë nëse do ta përcjellë kërkesën në fjalë për të vendosur në nivel ministror. Procedura e përcjelljes së kërkesës do të përcaktohet përmes aktit nënligjor të cilin do ta nxjerr Qeveria sipas propozimit të Ministrisë.
9. Për kryerjen e detyrave të veta, Komisioni mund të kërkojë asistencë, këshilla dhe veprime tjera nga ministritë tjera, institucionet dhe ekspertët e fushave përkatëse. Procedura për kërkimin e këshillave nga ministritë tjera, institucionet dhe ekspertët e fushave përkatëse do të përcaktohet përmes aktit nënligjor të cilin e nxjerr Qeveria sipas propozimit të Ministrisë.
10. Komisioni mund të kërkojë asistencë, këshilla dhe veprime tjera nga Agjencia Kosovare e Inteligjencës dhe Agjencioni për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Nukleare për eksport, transit, trans-ngarkim, ri-eksportim jashtë territorial ose ri-transferim dhe për ofrimin e shërbimeve të ndërlidhura.
11. Nëse ndonjë nga përfaqësuesit e Komisionit nuk është në gjendje ta japë qëndrimin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, atëherë Ministria kërkon arsyetimin me shkrim nga ministri përkatës për lëndën përkatëse.
12. Qeveria sipas propozimit të Ministrisë aprovon aktin nënligjor për funksionimin e Punës së Komisionit.

Neni 5
Përgjegjësia për kontrollimin e tregtisë me mallra strategjike

1. Ministria është institucioni përgjegjës i cili zbaton kontrollin e mallrave strategjike dhe kryen punë administrative të Komisionit.
2. Me qëllim të zbatimit të paragrafit 1. të këtij neni, Ministria themelon Departamentin specifik për kontrollin e tregtisë me mallra strategjike.
3. Struktura organizative e departamentit, fushë veprimtaria dhe zbatimi, rregullohet me aktin nënligjor për strukturim të MTI-së të cilin do ta aprovoj Qeveria.

Neni 6
Lista e mallrave që i nënshtrohen licencimit

Qeveria, me propozimin e Ministrisë, përmes një vendimi miraton dhe përditëson Listën Shtetërore e Mallrave të Kontrolluara Strategjike që i nënshtrohen këtij ligji. Lista Shtetërore e Mallrave të Kontrolluara Strategjike përfshinë Listën Evropiane të mallrave me përdorim të dyfishtë dhe Listat e përbashkët ushtarake si dhe mallrat të cilët vihen nën kontroll për shkaqe të sigurisë kombëtare, politikës së jashtme, sigurisë publike ose për arsye të drejtave të njeriut.

Neni 7
Fushëveprimi i kontrollit

1. Licenca kërkohet për eksport, import, transit, trans-ngarkim, ri-eksportim jashtë territorial dhe ri-transferim të mallrave nga Lista Shtetërore e Mallrave të Kontrolluara Strategjike si dhe për ofrimin e shërbimeve të ndërlidhura.
2. Ministria me akt nënligjor përcakton formën dhe përmbajtjen e licencës nga paragrafi 1. i këtij neni.
3. Importi, eksporti, transiti, trans-ngarkimi, ri-eksportimi jashtë territorial dhe ri-transferimi i mallrave nga Lista Shtetërore e Mallrave të Kontrolluara Strategjike si dhe ofrimi i shërbimeve të ndërlidhura kryhet në bazë të licencës së lëshuar nga Ministria bazuar në vendimin e Komisionit.
4. Licenca për eksport, import, transit, trans-ngarkim ose ofrim të shërbimeve të ndërlidhura kërkohet për mallrat që nuk janë pjesë e Listës Shtetërore e Mallrave të Kontrolluara Strategjike, atëherë kur:
 - 4.1. eksportuesi, personi që kryen transitin, personi që kryen trans-ngarkimin ose ofruesi i shërbimeve të ndërlidhura informohet nga Ministria se mallrat në fjalë janë apo mund të përdoren, në tërësi ose pjesërisht në lidhje me zhvillimin, prodhimin, trajtimin, operimin, mirëmbajtjen, magazinimin, identifikimin, detektimin ose përhapjen e armëve kimike, biologjike ose bërthamore ose pajisjeve tjera bërthamore, ose për zhvillimin, prodhimin, mirëmbajtjen, ose magazinimin e mjeteve për dërgimin e tyre;
 - 4.2. shteti blerës ose shteti i destinacionit i nënshtrohet embargos së armëve të miratuar nga Këshilli i Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, veprimet në bazë të vendimit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian ose Bashkimit Evropian dhe kur eksportuesi, personi që kryen transitin, personi që kryen trans-ngarkimin ose ofruesi i shërbimeve të ndërlidhura informohet nga Ministria se mallrat në fjalë janë apo mund të kenë për qëllim, në tërësi apo pjesërisht, përdorimin përfundimtar për qëllime ushtarake;
 - 4.3. eksportuesi, personi që kryen transitin, personi që kryen trans-ngarkimin ose ofruesi i shërbimeve të ndërlidhura informohet nga Ministria se mallrat janë apo mund të kenë për qëllim, tërësisht apo pjesërisht përdorimin si pjesë apo komponentë të mallrave për përdorim ushtarak nga Lista Shtetërore e Mallrave të Kontrolluara Strategjike.
5. Nëse eksportuesi, personi që kryen transitin, personi që kryen trans-ngarkimin ose ofruesi i shërbimeve të ndërlidhura e din se mallrat të cilat ka për qëllim t'i eksportojë, kalojë transit apo si trans-ngarkim, ose mallrat për të cilat ka për qëllim të ofrojë shërbime të ndërlidhura nuk janë pjesë e Listës Shtetërore e Mallrave të Kontrolluara Strategjike dhe që janë të dedikuara tërësisht apo

pjesërisht për cilëndo nga qëllimet e specifikuar në nën-paragrafët prej 4.1 deri në 4.3, paragrafin 4 të këtij neni, atëherë eksportuesi, personi që kryen transitin, trans-ngarkimin ose ofruesi i shërbimeve të ndërlidhura për këtë duhet ta informojë Ministrinë. Ministria vendos se a do të nevojitet licenca për eksport ose ofrim të shërbimeve të ndërlidhura.

6. Licenca lëshohet nga Ministria bazuar në aprovimin e Komisionit, përveç në rastet kur:

6.1. Autorizimi për importin e mallrave strategjike të dedikuara për Forcën e Sigurisë së Kosovës ose institucionet shtetërore të autorizuar të sigurisë, lëshohet nga Ministria e Forcës së Sigurisë ose Ministria e Punëve të Brendshme;

6.2. Autorizimi për eksportin e përkohshëm të mallrave strategjike për Ministrinë e Forcës së Sigurisë të Kosovës ose institucionet shtetërore të autorizuar të sigurisë lëshohet nga Ministria e Forcës së Sigurisë ose nga Ministria e Punëve të Brendshme;

6.3. Autorizimi për importin e mallrave strategjike të pranuar si donacione nga Qeveria e Republikës së Kosovës lëshohet nga Ministria e Forcës së Sigurisë ose Ministria e Punëve të Brendshme, nëse mallrat e tilla janë të përcaktuara të jenë pjesë e kompetencës së tyre ose kompetencës së institucioneve shtetërore të autorizuar të sigurisë;

6.4. Autorizimi për eksportin e mallrave strategjike bazuar në marrëveshjet e nënshkruara nga Qeveria e Republikës së Kosovës lëshohet nga Ministria e Forcës së Sigurisë të Kosovës;

6.5. Autorizimi për eksportin, transitin dhe trans-ngarkimin e mallrave strategjike të cilat veprojnë në kuadër të misionit ushtarak, paqeruajtës ose humanitar, lëshohet nga Ministria e Forcës së Sigurisë të Kosovës;

6.6. Autorizimi për eksport, import, transit dhe trans-ngarkim të mallrave strategjike të cilat do të përdoren për veprimtaritë hulumtuese, në lidhje me veprimtarinë e hetimeve ligjore që kanë për qëllim zbatimin e këtij ligji, lëshohet nga zyrat përkatëse të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Neni 8

Certifikata e përdorimit të fundit e lëshuar në emër të Republikës së Kosovës

1. Me kërkesën e përdoruesit të fundit, Ministria ia lëshon përdoruesit të fundit certifikatën e përdorimit të fundit për import dhe përdorim të fundit të mallrave strategjike dhe ofrim të shërbimeve të ndërlidhura.

2. Ministria, me akt nënligjor përcakton formën dhe përmbajtjen e certifikatës nga paragrafi 1. i këtij neni.

3. Dokumenti kontrollues për Certifikatën e përdoruesit të fundit të lëshuar nga Ministria, mund të revokohet vetëm për atë pjesë ku mallrat e përfshirë nuk janë importuar në Republikën e Kosovës.

4. Kontrolli i përdorimit të fundit të mallrave të importuara strategjike ushtrohet nga institucionet relevante mbi bazën e dokumenteve kontrolluese për përdorimin e fundit. Kur institucionet zbatuese zbulojnë ndonjë shkelje përkitazi me mallrat strategjike, ato janë të obliguara ta njoftojnë Ministrinë menjëherë.

Neni 9

Regjistrimi në regjistrin e tregtarëve të mallrave strategjike

1. Para fillimit të eksportit, importit ose ofrimit të shërbimeve të ndërlidhura, personat të cilët e kryejnë këtë veprimtari janë të obliguar të regjistrohen në regjistrin e tregtarëve me mallra strategjike. Regjistrimi do të jetë parakusht për të aplikuar për licencë të eksportit, importit apo ofrimit të shërbimeve të ndërlidhura.

2. Departamenti krijon dhe mirëmban regjistrin e tregtarëve të mallrave strategjike.

3. Departamenti do të vendosë nëse eksportuesi, importuesi ose ofruesi i shërbimeve të ndërlidhura do të pranohen në regjistrin e tregtarëve të mallrave strategjike. Ministria mund të kërkojë nga anëtarët e Komisionit ose autoritetet kompetente mendim këshillues lidhur me kërkesën për regjistrim në regjistër.

4. Kryesuesi, anëtarët dhe zëvendës anëtarët e Komisionit kanë të drejtë në qasje informative në regjistrin e tregtarëve të mallrave strategjike.

5. Palët e treta do të kenë qasje në regjistrin e tregtarëve të mallrave strategjike nëse ato kanë interes të justifikuar dhe nëse Departamenti përcakton në përputhje me legjislacionin në fuqi. Departamenti mund ta refuzojë dhënien e informatës nëse parashtuesi i kërkesës nuk ka justifikim të mjaftueshëm ose kur qasja ose dhënia e informatës mund të dëmtojë interesat të regjistruarit për të cilin kërkohet ajo.

6. Forma e kërkesës, afatet dhe procedura për regjistrim në regjistrin e tregtarëve të mallrave strategjike, për fshirje nga regjistri dhe informatat të cilat duhet t'i ketë kërkesa për regjistrim përcaktohen me aktin nënligjor të nxjerrë nga Ministria.

7. Departamenti refuzon regjistrimin në regjistrin e tregtarëve të mallrave strategjike nëse:

7.1. parashtuesi i kërkesës paraqet rrejtshëm ose fshehtë faktet materiale ose dorëzon informata çorientuese, përfshirë dorëzimin e dokumenteve të rrejtshëm në lidhje me paraqitjen e kërkesës për regjistrim;

7.2. brenda pesë (5) viteve të kaluara, parashtuesi i kërkesës ka qenë përgjegjës për shkeljen e këtij ligji, aktet e tija nënligjore ose për shkeljen e dispozitave tjera ligjore që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare;

7.3. brenda pesë (5) viteve të kaluara, parashtuesi i kërkesës ka qenë përgjegjës për shkeljen e embargos ose sanksioneve ndërkombëtare;

7.4. kundër parashtuesit të kërkesës është nisur procedura penale për shkeljen e këtij ligji ose akteve të tija nënligjore ose është nisur procedurë civile ose penale ndaj parashtuesit të kërkesës e që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare;

7.5. departamenti konsideron se ekzistojnë shqetësime tjera për sigurinë kombëtare.

8. Kur Departamenti refuzon regjistrimin në regjistrin e tregtarëve të mallrave strategjike, parashtuesi i kërkesës ka të drejtë që Komisionit t'i paraqesë ankesën kundër atij vendimi. Procedura ankimore do të përcaktohet me aktin nënligjor të cilin do ta nxjerr Ministria.

9. Për ta ndryshuar regjistrimin në regjistër, parashtuesi i kërkesës duhet të dorëzojë pranë Departamentit një kërkesë me shkrim për ndryshimin përkatës. Nëse është e nevojshme, Departamenti mund të kërkojë dokumente shtesë.

10. Departamenti mund të refuzojnë ndryshimin e të dhënave në regjistrin e tregtarëve të mallrave strategjike.

11. Departamenti mund ta fshin personin juridik ose fizik nga regjistri i tregtarëve të mallrave strategjike. Procedura e fshirjes do të përcaktohet me aktin nënligjor të cilin do ta nxjerr Ministria.

Neni 10

Licencat për eksport, import, transit, trans-ngarkim, ri-eksportim jashtë territorial, ri-transferim jashtë territorial, ri-transferim dhe ofrim të shërbimeve të ndërlidhura

1. Në Republikën e Kosovës jepen këto lloje licencash:

1.1. Licenca individuale:

1.1.1. në bazë të aprovimit nga Komisioni, Ministria mund të lëshojë licencë individuale për eksport, import, transit, trans-ngarkim, ri-eksport jashtë territorial, ri-transferim ose ofrim të shërbimeve të ndërlidhura.

1.1.2. licenca individuale për eksport, import, transit, trans-ngarkim, ri-eksport jashtë territorial, ri-transferim ose ofrim të shërbimeve të ndërlidhura mund t'i nënshtrohet kushteve dhe kërkesave plotësuese në mënyrën të cilën e përcakton Ministria në licencë.

1.2. Licenca globale:

1.2.1. në bazë të aprovimit nga Komisioni, Ministria mund të lëshojë licencë globale.

1.2.2. licenca globale mund t'i nënshtrohet kushteve dhe kërkesave plotësuese në mënyrën të cilën e përcakton Ministria në licencë.

1.3. Licenca e përgjithshme:

1.3.1. Ministria mund të lëshojë licencë të përgjithshme e cila mundëson eksportin, importin, transitin, ose trans-ngarkimin e mallrave strategjike të përcaktuar, ose ofrimin e shërbimeve të ndërlidhura e të përcaktuara, nën kushtet ose në shtetet e destinuara e të identifikuar në licencën e përgjithshme. Ministria duhet ta publikojë licencën e përgjithshme.

1.3.2. Licenca e përgjithshme mund të përdoret nga të gjithë personat e regjistruar si shfrytëzues të licencës së përgjithshme dhe në pajtim me kërkesat dhe kushtet e përcaktuara me këtë ligj dhe aktet përkatëse nënligjore.

1.3.3. Licenca e përgjithshme nuk mund të përdoret atëherë kur Ministria e ka informuar eksportuesin apo importuesin, personin që kryen transitin, trans-ngarkimin ose ofruesin e shërbimeve të ndërlidhura se mallrat në fjalë janë apo mund të përdoren, tërësisht apo pjesërisht, për cilindo nga qëllimet e identifikuar në nenin 7, paragrafët 4. dhe 5. të këtij ligji, ose kur eksportuesi, importuesi, personi që kryen transitin, trans-ngarkimin, ose ofruesi i shërbimeve të ndërlidhura është në dijeni se mallrat janë të destinuar për atë qëllim.

2. Ministria përmes aktit nënligjor do ta rregullojë procedurën e parashtrimit të kërkesës.

3. Ministria përmes aktit nënligjor do të përcaktojë formën dhe përmbajtjen e licencave.

Neni 11

Hedhja poshtë e kërkesës për licencë

1. Nëse kërkesa është e pakompletuar ose e pasaktë, Ministria duhet ta njoftoj aplikuesin brenda afatit prej pesë (5) ditë pune dhe të kërkoj të e kompletoj kërkesën brenda afatit të përcaktuar nga Ministria.

2. Nëse parashtruesi i kërkesës dështon ta kompletoj kërkesën edhe pas këtij afati shtesë, kërkesa do ti hidhet poshtë pa ndërmarrë asnjë veprim.

3. Nëse parashtruesi i kërkesës parashtron kërkesë për një transakcion për mallrat për të cilat nuk mbulohen me këtë ligj, kërkesa do ti hidhet poshtë pa ndërmarrë asnjë veprim.

Neni 12

Afati për shqyrtimin e kërkesës për licencë nga Komisioni

1. Lidhur me kërkesën për licencë, Komisioni vendos brenda njëzetë (20) ditëve të punës nga dita e paraqitjes së kërkesës, ose brenda dyzetë (40) ditëve të punës atëherë kur në kuadër të procedurës paraqitet nevoja e ndërmarrjes së verifikimeve plotësuese për ta aprovuar licencën.

2. Ministria do ta njofton parashtruesin e kërkesës menjëherë pasi Komisioni të vendosë se procedura do të zgjasë deri në dyzetë (40) ditë.

Neni 13

Afati për lëshimin e licencës

1. Ministria do të lëshon licencën e kërkuar brenda pesë (5) ditëve pune nga data e aprovimit të saj nga Komisioni.

2. Në rast se Komisioni refuzon ta jep aprovimin e tij për eksportin e kërkuar apo importin, transitin, trans-ngarkimin, ri-eksportin jashtë territorial, ri-transferimin ose ofrimin e shërbimeve të ndërlidhura, Ministria brenda pesë (5) ditëve pune është e detyruar ta njoftojë paraqitësin e kërkesës për vendimin negativ të Komisionit.

3. Ministria e njofton paraqitësin e kërkesës lidhur me arsyet legjitime për refuzimin nga Komisioni gjithnjë në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale apo Ligjin për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë si dhe me ligjet tjera relevante.

4. Në rastet kur Komisioni refuzon kërkesën për licencë, paraqitësi i kërkesës do të kërkon rishqyrtimin administrativ nga Komisioni brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të njoftimit për refuzimin e kërkesës për licencë, para se të inicioj konfliktin administrativ në gjykatën kompetente.

5. Komisioni rishqyrton kërkesën e aplikuesit brenda afatit prej njëzet (20) ditëve pune nga dita e pranimit të kërkesës dhe në rast se Komisioni përsëri ia refuzon kërkesën për aplikim, aplikuesi mund të bëjë inicioj konfliktin administrativ në gjykatën kompetente në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. Procedura për shqyrtim administrativ do të rregullohet me akt nënligjor që do të nxjerrët nga Ministria.

Neni 14

Pamundësia e bartjes së licencave, certifikatave dhe dokumenteve tjerë

1. Licencat, certifikatat dhe dokumentet tjerë të cilët lëshohen në pajtim me këtë ligj, nuk mund t'i barten personave tjerë.

2. Në rast të sjelljeve në kundërshtim me paragrafin 1. të këtij neni, personit të cilit i është dhënë licenca, certifikata ose dokumenti tjetër do t'i humb të gjitha të drejtat e parapara me këtë ligj.

Neni 15

Shqyrtimi dhe refuzimi i kërkesës për licencë

1. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për licencë eksporti, importi, transiti, trans-ngarkimi, ri-eksporti jashtë-territorial, ri-transferimi ose për ofrim të shërbimeve të ndërlidhura, Komisioni do të refuzojë kërkesën nëse konstatohen rrethanat e mëposhtme si në vijim:

1.1. se dhënia e licencës së kërkuar është në kundërshtim me politikën e jashtme ose interesat ekonomike të Republikës së Kosovës;

1.2. se dhënia e licencës mund të rrezikojë respektimin e detyrimeve dhe përgjegjësiive ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, në veçanti sanksionet e miratuara nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ose nga Bashkimi Evropian, marrëveshjet për mospërhapje dhe çështje tjera, si dhe detyrimet tjera ndërkombëtare;

1.3. se dhënia e licencës mund të rrezikojnë mbrojtjen dhe interesat e sigurisë të Republikës së Kosovës;

1.4. se transaksionit është në kundërshtim me strategjinë e sigurisë kombëtare të Republikës së Kosovës;

1.5. se dhënia e licencës do të rrezikon respektimin e të drejtave të njeriut në shtetin e destinacionit ose respektimin e të drejtës ndërkombëtare humanitare në shtetin e destinacionit;

1.6. se dhënia e licencës do të mund të kontribuonte në ngritjen e tensioneve ose konflikt të armatosur në shtetin e destinacionit;

1.7. se dhënia e licencës do të mundëson që mallrat strategjike të arrijnë në posedim të palëve të refuzuara;

1.8. se qëndrimet e shtetit të destinacionit ndaj terrorizmit, karakteri i aleancave dhe respektimi i të drejtës ndërkombëtare nga ai shtet nuk është në pajtim me ato të Republikës së Kosovës;

1.9. se ekziston rreziku që mallrat të devijojnë, ri-transferohen ose ri-eksportohen nën kushte të padëshirueshme;

1.10. se mallrat janë në s'përputhje me të dhënat teknike dhe kapacitetet ekonomike të shtetit pranues, duke marrë në konsideratë dëshirën e shtetit që t'i plotësoj nevojat e veta legjitime për siguri dhe mbrojtje me devijim të vogël të resurseve njerëzore dhe ekonomike për armatim;

1.11. se mallrat për të cilat kërkohet licenca janë objekt i hetimeve policore ose procedurave gjyqësore.

1.12. brenda pesë (5) viteve të kaluara, parashtuesi i kërkesës ka qenë përgjegjës për shkeljen e këtij ligji, aktet e tija nënligjore ose për shkeljen e dispozitave tjera ligjore që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare;

1.13. brenda pesë (5) viteve të kaluara, parashtuesi i kërkesës ka qenë përgjegjës për shkeljen e embargos ose sanksioneve ndërkombëtare;

1.14. kundër parashtuesit të kërkesës është nisur procedura penale për shkeljen e këtij ligji ose akteve të tija nënligjore ose është nisur procedurë civile ose penale ndaj parashtuesit të kërkesës e që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare;

1.15. si dhe rrethana tjera relevante për sigurinë kombëtare dhe politikën e jashtme.

Neni 16

Vërtetësia dhe vlefshmëria ligjore e dokumentacionit

Në rast të dyshimit të arsyeshëm mbi vërtetësinë dhe vlefshmërinë ligjore të dokumentacionit të dorëzuar, Ministria me propozimin e Komisionit do t'ia përcjellë të njëjtin autoriteteve kompetente për trajtim të mëtejshëm.

Neni 17

Rieksperti dhe ritransferimi i mallrave strategjike të importuara paraprakisht

1. Nëse personi paraprakisht ka importuar mallra në Republikën e Kosovës dhe dëshiron me i ritransferu këto mallra te një shfrytëzues tjetër i fundit, atëherë Ministria mund të kërkojë që personi të dorëzojë aprovimin e autoriteteve kompetente të shtetit nga i cili mallrat ishin importuar në Republikën e Kosovës.

2. Në rastin e eksportit të mallrave të importuara më parë, Ministria mund të kërkojë nga paraqitësi i kërkesës kërkesën për aprovim të eksportit dhe dorëzimin e ndryshimeve të përdoruesit të fundit të mallrave, të lëshuar nga autoritetet kompetente të shtetit prej të cilit janë importuar mallrat.

Neni 18

Lëshimi i licencës për transaksionet të cilat përfshijnë shtetet nën masat e ndalimit apo masa kufizuese

1. Me rastin e paraqitjes së kërkesës për licencë eksporti, transiti, trans-ngarkimi, ri-eksporti jashtë territorial, ri-transferimi ose për ofrim të shërbimeve të ndërlidhura ku përfshihet shteti, subjekti, ose personi juridik a fizik i cili bën pjesë në listën e shteteve, subjekteve dhe personave juridikë a fizikë ndaj të cilëve janë vënë masa ndalimi ose kufizimi nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë ose nga organizatat tjera ndërkombëtare, dhe anëtar e të cilave është Republika e Kosovës, mund t'i lëshohet licencë vetëm për qëllime humanitare ose për nevoja ruajtjes së paqes.

2. Në përputhje me politikën e jashtme dhe interesat e sigurisë kombëtare të Republikës së Kosovës, Ministria përmes aktit nënligjor mund ta përpilojë listën e shteteve, subjekteve dhe personave juridikë a fizikë të cilët janë objekt i masave ndaluese dhe kufizuese të eksportimit, importimit, transimit, trans-ngarkimit, ri-eksportimit jashtë territorial, ri-transferimit ose të dhënies së shërbimeve të ndërlidhura.

Neni 19

Njoftimi për subjektet para nënshkrimit të kontratës për blerje ose shitje të mallrave dhe shërbimeve strategjike

Para nënshkrimit të kontratës për blerjen ose shitjen e mallrave ose shërbimeve strategjike, me kërkesë të personave, Ministria mund ta njoftojë personin se aktiviteti i negociuesit, blerësit, shitësit, importuesit, eksportuesit, përdoruesit të fundit ose palës tjetër të transaksionit është në kundërshtim me dispozitat e nenit 18 të këtij ligji.

Neni 20

Lëshimi i certifikatës ndërkombëtare të importit dhe vërtetimit për dërgimin e mallrave strategjike

1. Nëse shteti eksportues i mallrave strategjike kërkon nga organet kompetente të Republikës së Kosovës certifikatën e importit të atyre mallrave, Ministria do ta lëshojë certifikatën ndërkombëtare të importit ose certifikatën për vërtetimin e dërgimit për mallrat strategjike.

2. Procedura, forma dhe përmbajtja e kërkesës për këtë certifikatë përcaktohet nga Ministria përmes aktit përkatës nënligjor.

Neni 21

Baza e të dhënave, bashkëpunimi dhe raportimi

1. Ministria detyrohet të mbajë bazën e të dhënave e cila përmban licencat e kërkuara, lëshuara dhe të përdorura si dhe ato të ndryshuara, pezulluara, revokuara dhe anuluar, dhe refuzimet e kërkesave për licencë dhe aktivitetet pas zbatimit të licencës për eksport, transit, trans-ngarkim, ri-eksport jashtë territorial, ri-transferim dhe ofrim të shërbimeve të ndërlidhura në bazë të dispozitave të këtij ligji.

2. Për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, Ministria brenda kompetencave të veta mund të bashkëpunon me autoritetet kompetente të Qeverisë së Republikës së Kosovës, shkëmbejë informata me ta, të kërkojë informata në mënyrën e cila është në përputhje me ligjet për mbrojtjen e informatave sekrete në Republikën e Kosovës.

3. Për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, Ministria brenda kompetencave të veta mund të bashkëpunon me organizata ndërkombëtare dhe me organet kompetente të shteteve tjera, t'ju ofroj atyre informatat gjegjëse në përputhje me detyrimet që i ka marrë përsipër Republika e Kosovës.

4. Ministria merr pjesë në shkëmbin e informatave me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, lidhur me eksportin, importin, transimin, trans-ngarkimin, ri-eksportin jashtë territorial, ri-transferimin dhe ofrimin e shërbimeve të ndërlidhura me mallrat strategjike.

5. Para 30 prillit të vitit kalendarik, Ministria e përgatit dhe ia dërgon Qeverisë së Republikës së Kosovës versionin e fshehtë të raportit vjetor për vitin paraprak për tregtinë me mallra strategjike dhe aktivitetet e Komisionit.

6. Para 30 majit të vitit kalendarik, Ministria përgatit versionin për publikim në ueb-faqen e Ministrisë.

Neni 22

Detyrimet e personave të cilët merren me eksport, import, transit, trans-ngarkim, ri-eksport jashtë territorial dhe ri-transferim të mallrave strategjike si dhe ofrim të shërbimeve të ndërlidhura

1. Personat që merren me eksport, import, transit, trans-ngarkim, ri-eksport jashtë territorial dhe ri-transferim të mallrave strategjike si dhe ofrim të shërbimeve të ndërlidhura me mallrat strategjike janë të obliguar të:

1.1. Arkivojnë dokumentacionin në vijim në kohëzgjatje prej të paktën tridhjetë (30) vjet nga përfundimi i eksportit, importit, transinit, trans-ngarkim, ri-eksportit jashtë territorial ose ri-transferimit të mallrave strategjike:

1.1.1. përshkrimi teknik i mallrave dhe shërbimeve cili mundëson klasifikimi e mallrave në Listën Shtetërore të Mallrave të Kontrolluara Strategjike në përputhje me këtë ligj, me nomenklaturën e tarifave doganore dhe sipas nevojës, klasifikimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për mallrat e rrezikshme;

1.1.2. sasia e mallrave në njësi matëse dhe pesha neto e mallrave;

1.1.3. emri i plotë dhe adresa e eksportuesit, importuesit, personit që kryen transinit, trans-ngarkimin, ri-eksportuesit jashtë territorial, ri-transferuesit dhe ofruesit të shërbimeve të ndërlidhura dhe informatat përkatëse nga regjistri i tregtarëve të mallrave strategjike kur kjo është e mundur;

1.1.4. emri i plotë dhe adresa e shitësit apo pranuesit të mallrave;

1.1.5. emri i plotë dhe adresa e përdoruesit të fundit të mallrave;

1.1.6. përshkrimi i shërbimeve të ndërlidhura, emri i plotë dhe adresa e pranuesit(ve) dhe palëve tjera të shërbimeve të ndërlidhura (kur kjo është e mundur);

1.1.7. çdo korrespondencë afariste, shkëmbim me postë elektronike (e-mail) dhe regjistrim audio-video që ndërlidhet me eksport, import, transit, trans-ngarkim, ri-eksport jashtë territorial dhe ri-transferim të mallrave strategjike si dhe ofrim të shërbimeve të ndërlidhura me mallrat strategjike;

1.1.8. urdhëresat, faturat, kontratat, fletëngarkesat, flet-dërgesat, listat e ngarkimit dhe dokumentacioni tjetër që ndërlidhet me eksport, import, transit, trans-ngarkim, ri-eksport jashtë territorial dhe ri-transferim të mallrave strategjike si dhe ofrim të shërbimeve të ndërlidhura me mallrat strategjike;

1.1.9. çdo dokumentacion tjetër të përcaktuara nga Ministria varësisht nga rasti konkret;

1.2. në bazë të kërkesës së Ministrisë apo organit tjetër mbikëqyrës, t'ia ofrojnë dokumentacionin e tillë zyrtar të Ministrisë ose organit tjetër mbikëqyrës;

1.3. të respektojnë kushtet nën të cilat është dhënë licenca dhe ta informojnë menjëherë Ministrinë për çdo ndryshim që ka ndodhur gjatë eksportit, importit, transinit, trans-ngarkimit, ri-eksportit jashtë territorial dhe ri-transferimit të mallrave strategjike si dhe ofrimit të shërbimeve të ndërlidhura;

1.4. me shkrim ta njoftojnë Ministrinë për çdo ndryshim përkitazi me përdoruesin e fundit apo për palën tjetër në eksport, import, transit, trans-ngarkim, ri-eksport jashtë territorial dhe ri-transferim të mallrave strategjike ose ofrim të shërbimeve të ndërlidhura brenda dhjetë (10) ditëve nga dita ndryshimit;

1.5. brenda shtatë (7) ditëve të përfundimit të eksportit, importit, transitit, trans-ngarkimit, ri-eksportit jashtë territorial dhe ri-transferimit të mallrave strategjike si dhe ofrimit të shërbimeve të ndërlidhura, ta njoftojnë Ministrinë me shkrim lidhur me përfundimin e eksportit, importit, transitit, trans-ngarkimit, ri-eksportit jashtë territorial, ri-transferimit të mallrave strategjike si dhe ofrimit të shërbimeve të ndërlidhura dhe t'ia dorëzojë dokumentacionin mbi të cilin realizuar ato;

1.6. me kërkesë të Ministrisë të sigurojnë vërtetimin e dorëzimit dhe pranimit të mallrave;

1.7. në dokumentacionin e rëndësishëm komercial që ka të bëjë me transferimin vendor të mallrave strategjike të prodhuara në Republikën e Kosovës, të tregojnë qartë se këto mallra i nënshtrohen kontrollit kur ato eksportohen nga Republika e Kosovës; ky dokumentacion përmban në veçanti kontratat e shitjes, vërtetimin e porosisë, faturat, apo flet-dërgesën;

1.8. ta kthejnë çdo licencë të përdorur në Ministri brenda shtatë (7) ditëve të realizimit të transaksionit përkatës;

1.9. ta kthejnë çdo licencë të papërdorur ose certifikatë në Ministri brenda shtatë (7) ditëve nga dita e skadimit të licencës ose certifikatës;

1.10. të respektojnë detyrimet tjera, kushtet dhe afatet e përcaktuar me licencë ose certifikatë të lëshuar nga Ministria në përputhje me këtë ligj.

Neni 23

Programi i brendshëm i pajtueshmërisë

1. Ministria mund të kërkon, prej rastit në rast, nga parashtuesit e kërkesave për licenca globale dhe përdoruesit e licencave të përgjithshme që ta krijojnë programin e brendshëm të detyruar mbi pajtueshmërinë (më tutje në tekst PBP). Në ato raste PBP i nënshtrohet certifikimit nga Ministria.

2. Parashtuesit e kërkesave për licenca globale dhe përdoruesit e licencave të përgjithshme për të cilët Ministria ka vendosur ta kenë PBP-në e detyruar, duhet të paraqesin kërkesë pranë Ministrisë për certifikimin e PBP-së. Me rastin e vendosjes për ta certifikuar apo jo një PBP, Ministria merr parasysh rrethanat si në vijim:

2.1. numrin e të punësuarve tek parashtuesi i kërkesës, vëllimin tregtar, karakterin e transaksioneve, profilin e pranuesve të dërgesave, deklaratimet e përdorimit të fundit të mallrave strategjike dhe shërbimeve të ndërlidhura; përvojën e dëshmuar në trajtimin dhe menaxhimin e tregtisë me mallra strategjike dhe shërbime të ndërlidhura; të dhënat e pajtueshmërisë me kontrollin e tregut strategjik; vendimet relevante gjyqësore; licencat për prodhim ose tregtim me mallra strategjike dhe/ose shërbime përkatëse dhe përvojën e stafit drejtues;

2.2. emërimin e një zyrtari të lartë ligjor nga parashtuesi i kërkesës si zyrtar përgjegjës për menaxhimin e kontrollit të tregtisë me mallra strategjike dhe shërbimet e ndërlidhura;

2.3. zotimin në formë të shkruar nga parashtuesi i kërkesës dhe nënshkruar nga zyrtari i lartë ligjor nga nën-paragrafi 2.2. të këtij neni, që do t'i ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për mbikëqyrjen dhe zbatimin e të gjitha kushteve specifike që kanë të bëjnë me përdorimin e fundit dhe kontrollin e tregtisë me mallra strategjike të secilës komponentë specifike ose produkt të pranuar ose eksportuar.

2.4. zotimin në formë të shkruar nga parashtuesi i kërkesës dhe nënshkruar nga zyrtari i lartë ligjor nga nën-paragrafi 2.2. i këtij neni, për t'i ofruar Ministrisë informatat e hollësishme mbi veprimet e ndërmarra nga parashtuesi i kërkesës për procedurat e kryerjes së kontrolleve

dhe verifikimeve të përdoruesve të fundit të të gjitha mallrave strategjike që do të eksportohen, importohen, kalojnë transit, trans-ngarkohen, ri-eksportohen jashtë territorit, ri-transferohen ose shërbimet që do të ofrohen;

2.5. pajtueshmëria e PBP-së së implementuar nga parashtruesi i kërkesës me udhëzimet e përcaktuara nga Ministria.

3. Ministria në bashkëpunim me Komisionin ndihmon personat juridikë dhe fizikë në zhvillimin e PBP-ve të veta dhe do t'ju ofrojë informatat dhe udhëzimet e nevojshme.

4. Përfaqësuesit e autorizuar të Ministrisë dhe/ose anëtarëve relevantë të Komisionit mund ta inspektojnë PBP-në.

5. Në rast se inspektimi gjen se PBP nuk i përmbush kriteret e identifikuar në paragrafin 2. të këtij neni ose udhëzimet e përcaktuara nga Ministria, kjo e fundit do t'i ndërmerr masat e përshtatshme sipas aprovimit nga Komisioni. Këto masa mund të përfshijnë pezullimin ose revokimin e licencës globale ose shfrytëzimin e licencës së përgjithshme.

6. Emrat e shoqërive me PBP të inspektuara do t'i publikojë Ministria.

7. Ministria detyrohet t'i përcaktojë dhe publikojë udhëzimet për PBP.

Neni 24

Ngritja e vetëdijesimit për dispozitat e këtij ligji

Ministria në bashkëpunim me Komisionin është përgjegjëse për ofrimin e informatave dhe realizimin e programeve për ngritjen e vetëdijesimit tek të gjitha palët e interesuara për të mundësuar pajtueshmëri më efektive të dispozitave të këtij ligji dhe akteve përkatëse nënligjore.

Neni 25

Mbikëqyrja e zbatimit të sistemit të licencimit

1. Ministria është përgjegjëse për sigurimin e pajtueshmërisë së eksportuesve, importuesve, personave që kryejnë transitin, trans-ngarkimin, ri-eksportuesve jashtë territorial, ri-transferuesve dhe ofruesve të shërbimeve të ndërlidhura me detyrimet, afatet dhe kushtet e licencave dhe dispozitave të këtij ligji, në bashkëpunim me organet tjera të përfshira në procesin e dhënies së licencave dhe organet tjera shtetërore në përmbushjen e përgjegjësisë të tyre.

2. Mbikëqyrja e zbatimit përshinë mbikëqyrjen para, gjatë dhe pas lëshimit të licencës.

3. Gjatë mbikëqyrjes së zbatimit, Ministria në bashkëpunim me institucionet tjera relevante mund të:

3.1. kërkoj nga paraqitësi ose bartësi i licencës informata të nevojshme për zbatimin e mbikëqyrjes;

3.2. të Inspektoj dokumentet e paraqitësit ose bartësit të licencës ose objektet afariste, duke përfshirë këtu zyrat, objektet prodhuese, depot dhe qendrat e shpërndarjes që kanë të bëjnë me mallrat e strategjike të licencuara ose mallrat për të cilat paraqitësi kërkon licencë, si dhe vetë mallrat;

3.3. kërkoj informata nga institucionet tjera qeveritare dhe shërbime tjera të nevojshme për zbatimin e mbikëqyrjes;

3.4. kërkoj asistencë nga autoritetet kompetente të shteteve tjera me qëllim të mbledhjes së informatave plotësuese të nevojshme për zbatimin e mbikëqyrjes;

3.5. të mbikëqyrë pajtueshmërinë e bartësit të licencës me detyrimet, afatet dhe kushtet e licencës së lëshuar;

3.6. të mbikëqyrë përdoruesit e fundit të mallrave.

4. Ministria dhe organet tjera mbikëqyrëse janë të detyruara ta ruajnë fshehtësinë e sekreteve zyrtare, sekreteve tregtare dhe prodhuese dhe identitetin e personave që i nënshtrohen mbikëqyrjes.

5. Organi kompetent shtetëror i dorëzon Ministrisë rezultatet e mbikëqyrjes në formën e një raporti të shkruar.

6. Në rast të parregullsive, Ministria e njofton organin kompetent shtetëror për procedura të mëtutjeshme.

Neni 26

Mbikëqyrja e doganave dhe zhdoganimi i mallrave strategjike

1. Ministria duhet t'ia dorëzojë Doganave të Kosovës kopjen e licencës së lëshuar për eksport, import, transit, trans-ngarkim, dhe ofrim të shërbimeve të ndërlidhura me mallrat strategjike.

2. Doganat e Kosovës janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e eksportit aktual, importit, transinit, trans-ngarkimit apo ndonjë procedurë tjetër doganore që lidhet me mallrat strategjike dhe për vlerësimin e përputhjes së mallit me licencën e lëshuar.

3. Eksportuesi, importuesi, personi që kryen transinitin ose trans-ngarkimin e mallrave strategjike të licencuara është i detyruar të prezantojë këto informata në deklaratën doganore për mallrat:

3.1. emrin e plotë dhe adresën e bartësit të licencës;

3.2. numrin e licencës për eksport, import, transit ose trans-ngarkim për të cilën është iniciuar procedura doganore;

3.3. përshkrimin e mallrave në pajtim me licencën e lëshuar;

3.4. sasinë e mallit në njësi matëse të shënuar në licencë;

3.5. vlerën e mallrave të shprehur në para të përcaktuar në licencë;

3.6. nomenklaturën e duhur tarifore për mallrat;

3.7. klasifikimin e mallrave strategjike të përcaktuar në licencë, bazuar në sistemin e klasifikimit të mallrave të përdorur në Listën Shtetërore të Mallrave të Kontrolluara Strategjike;

3.8. klasifikimin e mallrave të rrezikshme, nëse është e zbatueshme.

4. Në kryerjen e detyrave të përcaktuara në paragrafin 2. të këtij neni, dhe për të përcaktuar se a janë mallrat në pajtim me licencën e lëshuar, Doganat mund të kërkojnë asistencë nga Ministria në identifikimin e mallrave strategjike të cilat do të eksportohen, importohen, kalojnë transit, ose trans-ngarkohen.

5. Nëse Doganat e Kosovës vërtetojnë se janë shkelur dispozitat e këtij ligji, ajo mund të lëshojë një urdhër në të cilin do të përcaktohet afati kohor brenda të cilit duhet të zgjidhen parregullsitë.

6. Çdo gjashtë (6) muaj, Doganat e Kosovës duhet ta njoftojnë me shkrim Ministrinë lidhur me gjetjet e saj përkitazi me mbikëqyrjen e eksporteve, importeve, transiteve, trans-ngarkimeve dhe transportimeve të mallrave strategjike.

Neni 27

Anulimi, revokimi, kufizimi, pezullimi dhe ndryshimi i licencës

1. Në bazë të vendimit të Komisionit licencën e anulon Ministria kur ajo është nxjerrë bazuar në pretendimet e rrejshme, përfaqësim çorientues ose fshehje të fakteve materiale. Në ato raste licenca është e nule dhe e pavlefshme dhe çdo aktivitet mbi bazën e saj konsiderohet si i pa qenë.

2. Në bazë të vendimit të Komisionit, licencën e revokon Ministria atëherë kur:

- 2.1. revokimin e kërkon bartësi i licencës;
- 2.2. dalin fakte të reja të cilat po të ishin ditur ose po të ekzistonin në kohën e paraqitjes së kërkesës do të kishin rezultuar me refuzim;
- 2.3. ndodh ndryshim substancial të informatave në licencë;
- 2.4. bartësi i licencës nuk i përmbush detyrimet, afatet dhe kushtet nga licenca;
- 2.5. bartësi i licencës e shkel këtë ligj dhe aktet përkatëse nënligjore ose dispozitat tjera ligjore mbi sigurinë shtetërore;
- 2.6. bartësi i licencës nuk i përmbahet kërkesave të Ministrisë për informata plotësuese lidhur me licencën;
- 2.7. licenca shkatërrohet ose humbet;
- 2.8. vdes personi fizik i cili është bartësi i licencës;
- 2.9. shpërbëhet ose nuk ekziston më personi juridik i cili është bartës i licencës;
- 2.10. komisioni bëhet njoftohet mbi arsyet tjera të sigurisë shtetërore.

3. Në bazë të vendimit të Komisionit, Ministria mund ta kufizojnë licencën në përputhje me nën-paragrafët 2.1. deri 2.6. dhe 2.10. të këtij neni.

4. Ministria pezullon vlefshmërinë e licencës deri në vërtetimin e fakteve të specifikuara në nën-paragrafët 2.2 deri 2.6 dhe 2.10 të këtij neni.

5. Ministria e njofton menjëherë Doganën dhe institucionet qeveritare tjera mbi anulimin, revokimin, kufizimin ose pezullimin e licencës.

6. Personi nuk ka të drejtë të paraqes ankesë ndaj vendimit të Komisionit për anulim ose revokim të licencës, por lejohet iniciimi i konfliktit administrativ para gjykatës kompetente.

7. Licencën mund ta ndryshon Ministria në bazë të vendimit të Komisionit kur nevojitet të zgjatet periudha e vlefshmërisë, ndryshohet destinacioni ose përdoruesi i fundit, dhe për shkaqe tjera.

Neni 28 Shkeljet

1. Secili person fizik ose juridik, ose personi përgjegjës në kuadër të personit juridik, është penalisht dhe/ose administrativisht i përgjegjshëm për shkeljet si në vijim:

- 1.1. angazhimi në veprimtarinë rregullative të ndaluar ose në kundërshtim me këtë ligj, ose aktet përkatëse nënligjore ose mos angazhimi në veprimet e obliguara me këtë ligj ose me aktet përkatëse nënligjore, duke përfshirë por duke mos u kufizuar vetëm në: dështimin për t'u regjistruar; veprimin pa autorizim; ose veprimin në shkelje të detyrimeve, afateve ose kushteve të licencës ose dokumentacionit për përdoruesin e fundit të lëshuar nga Ministria;
- 1.2. paraqitja e rrejshme ose çorientuese ose fshehja e fakteve materiale gjatë dorëzimit të çfarëdo dokumentacioni në Ministri;
- 1.3. dështimi për të vepruar në harmoni me urdhrat e nxjerrë nga Ministria apo agjencia qeveritare e paraparë me këtë ligj ose aktet përkatëse nënligjore ose angazhimi në aktivitet të ndaluar nga vendimet e lëshuar mbi bazën e këtij ligji ose akteve përkatëse nënligjore;

1.4. dështimi për të raportuar apo njoftuar Ministrinë ashtu siç kërkohet me këtë ligj dhe aktet përkatëse nënligjore;

1.5. dështimi për të respektuar kërkesat për ruajtjen e të dhënave ashtu si parashihet me këtë ligj dhe aktet përkatëse nënligjore;

1.6. nxitja për shkeljen e këtij ligji, aktet përkatëse nënligjore apo çfarëdo vendimi apo licence të lëshuar sipas tij;

1.7. shkaktimi, ndihma ose shtytja për shkeljen e këtij ligji, akteve përkatëse nënligjore dhe vendimeve apo licencave të lëshuara sipas tij;

1.8. tentativa për shkeljen e këtij ligji, akteve përkatëse nënligjore, ose vendimeve apo licencave të lëshuara sipas tij;

1.9. bashkëpunimi ose veprimi në marrëveshje me një apo më shumë persona në çfarëdo mënyre apo për çfarëdo qëllimi për të sjellë deri te, apo kryer çfarëdo veprimi që përbën shkelje të këtij ligji, akteve përkatëse nënligjore apo vendimeve a licencave të lëshuara sipas tij;

1.10. angazhimi në aktivitetet të cilat kanë për qëllim shmangien nga zbatimi i dispozitave të këtij ligji, akteve përkatëse nënligjore, vendimeve apo licencave të lëshuar sipas tij;

1.11. bllokimi apo pengimi i Ministrisë ose organeve qeveritare në ushtrimin e autorizimeve të dhëna me këtë ligj ose aktet përkatëse nënligjore;

1.12. falsifikimi ose ndryshimi i regjistrimeve, licencave, dokumenteve kontrolluese të përdorimit të fundit, certifikatave ose çfarëdo dokumenti tjetër të lëshuar mbi bazën e dispozitave të këtij ligji, akteve përkatëse nënligjore apo vendimeve a licencave të lëshuara sipas tij.

Neni 29

Sanksionet penale

1. Kushdo që shkel dispozitat e këtij ligji dhe kur shkelja ka shkaktuar dëme apo pasoja serioze për sigurinë e shtetit, politikën e jashtme apo sigurinë publike dënohet me burgim prej një (1) deri tetë (8) vite ose gjobë prej dhjetëmijë (10.000) € deri në tridhjetë mijë (30.000) €".

2. Përjashtimisht nga paragrafi 1. i këtij neni, në raste të veçanta, personi mund të dënohet edhe me katërfishin e vlerës së mallrave.

3. Gjykata vendos edhe për konfiskimin e mallrave që janë pjesë e shkeljes.

4. Personi fizik dhe juridik i cili kryen shkeljen e dispozitave të këtij ligji ose akteve përkatëse nënligjore mund t'i nënshtrohet ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë afariste në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 30

Sanksionet administrative

1. Përveç sanksioneve penale të cilat mund të shqiptohen mbi bazën e këtij ligji, Ministria mund të shqiptojë edhe sanksionet administrative si në vijim:

1.1. kufizimin, revokimin ose anulimin e licencave dhe/ose regjistrimit në përputhje me nenet 10 dhe 27, paragrafi 2.4., 2.5., 2.6. të këtij ligji;

1.2. shqiptimin e gjobës prej njëmijë (1.000) € deri në pesëmijë (5.000) € ose dyfishin e vlerës së mallit strategjik ose shërbimit të ndërlidhur sipas kontratës ose vlerësimit të Ministrisë ose shumën më të madhe nga këto dyja;

Neni 31
Zbatimi i dispozitave ligjore për lëshimin e licencave

Për procedurat e lëshimit të licencave për eksport, import, transit, trans-ngarkim, ri-eksportim jashtë territorial dhe ri-transferim të mallrave strategjike, si dhe për ofrim të shërbimeve të ndërlidhura zbatohen dispozitat e ligjeve tjera në fuqi përveç kur ndryshe parashikohet me këtë ligj.

Neni 32
Nxjerrja e akteve nënligjore

Për zbatimin e këtij ligji, Ministria nxjerr aktet nënligjore brenda afatit tre (3) muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 33
Dispozita shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji nr. 03/L-232 për Tregtinë me mallra strategjike.

Neni 34
Hyrja në fuqi

Ky ligj hynë në fuqi tre (3) muaj pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji nr. 04/L-198
29 korrik 2013

Shpallur me dekretin Nr. DL-034-2013, datë 16.08.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga